



POLITIKA

POLITIKA E PRIVATËSISË

1. Hyrje

E drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale e shfrytëzuesve paraqet prioritet për Grupacionin Dojçe Telekom. Parimet për mbrojtjen e të dhënave personale të cilat janë të përpunuara në mënyrë më të detajuar në Rregullat korporative të patjetërsueshme për mbrojtjen e privatësisë së Dojçe Telekom zbatohen në kompanitë të cilat i takojnë Grupacionit.

2. Pjesa kryesore

Makedonski Telekom si anëtare e Grupacionit Dojçe Telekom, i kushton vëmendje të madhe mbrojtjes të së dhënave personale në të gjitha proceset e saja afariste, duke i zbatuar standardet e caktuara në rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Maqedonisë dhe standardet të cilat ekzistojnë në kuadër të Grupacionit.

Me qëllim që ta promovojmë konceptin e vendosur për mbrojtjen e privatësisë në Makedonski Telekom dhe ta shpjegojmë mënyrën se si i përpunojmë të dhënat personale të vizitorëve, gjatë vizitës ose regjistrimit të tyre në faqen e internetit tonë, e përgatitëm këtë Politikë të privatësisë. Kjo Politikë e privatësisë nuk ka të bëjë me vizitën e Juaj në faqet e tjera të internetit deri te cilat keni qasje përmes faqeve të tona të internetit.

Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave të juaja personale

Çfarë të dhënash personale përpunojmë?

Për shkak të mbrojtjes së sistemit, çdoherë kur do t'i viziton faqet e tona të internetit, ueb serverët tonë, përkohësisht e regjistrojnë Domenin e Juaj dhe IP adresën e stacionit të punës, së bashku edhe me disa të dhëna teknike në lidhje me sesionin, gjegjësisht me vizitën e faqeve të internetit. Gjithashtu, në raste të caktuara shënojmë informata në formën e „Cookies“ në kompjuterin e juaj, me qëllim që ta përshtasim vizitën e juaj në faqet e internetit sipas nevojave dhe shprehive të Juaja. „Cookies“ janë skedarë të vegjël të cilët shënohen në kompjuterin e vizitorit prej ueb serverit. Të gjitha informatat që rruhen në kuadër të „Cookies“ mund të përdoren për nevojat e shërbimeve të uebit, në mënyrë që nuk do të rrezikohet privatësia e Juaj.

Të dhënat e juaja personale i përpunojmë vetëm atëherë kur me vetë dëshirë i jepni përmes regjistrimit në faqet e tona të internetit për shkak të shfrytëzimit të prodhimeve dhe shërbimeve tona (p.sh. Pagesa e llogarisë elektronike, porositjet në mënyrë elektronike, anketa, lojëra shpërblyese), të cilat janë në pajtueshmëri me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale të Republikës së Maqedonisë.

Ju bëjmë me dije se gjatë pagesës elektronike të faturave, të dhënat që kanë të bëjnë me kartelën e Juaj pagesore ose me faturën në bankë dërgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë deri te banka përmes lidhjes me shifra. Makedonski Telekom as nuk i mbledh e as nuk ka qasje deri te këto të dhëna.

Për çfarë qëllimesh?

Të dhënat e juaja personale i përpunojmë me qëllim që t'iu mundësojmë shfrytëzim online të prodhimeve dhe shërbimeve tona. Të dhënat e juaja personale nuk do të përpunohen për asnjë qëllim tjetër, përveç se për qëllimin që janë mbledhur. Përpunimi i të dhënave të juaja personale për tjetër qëllim, mund të behet vetëm në bazë të pajtueshmërisë së Juaj paraprake.

A mund t'i ndajmë të dhënat e Juaja personale me persona të tjerë fizik dhe juridik, organe ose subjekte?

Të gjithë të punësuarit në kompanitë tona janë të obliguar t'i ruajnë të dhënat e Juaja personale dhe janë të trajnuar të sigurojnë fshehtësi dhe mbrojtje gjatë përdorimit dhe përpunimit të tyre.

Të dhënat e juaja personale nuk do të ndahen me personat e tjerë fizik dhe juridik, ose me organet shtetërore apo subjektet e tjera, përveç se në rastet kur kjo gjë është e përcaktuar me ligj.

Cilat janë të drejtat e juaja?

Në qoftë se jeni të regjistruar në faqet tona të internetit, në bazë të kërkesës së Juaj me shkrim keni të drejtë:

- Të jeni të informuar për atë se cilat të dhëna të juaja personale përpunohen për Ju dhe se cilat janë qëllimet dhe bazat ligjore të përpunimit të të dhënave dhe/ ose
- të keni qasje deri te të dhënat e Juaja personale dhe
- t'i plotësoni, ndryshoni, fshini ose të kërkontë ndalimin e përpunimit të mëtejshëm të tyre

Siguri dhe mbrojtje

Makedonski Telekom i ndërmerr të gjitha masat teknike dhe organizative për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjes të së dhënave gjatë përpunimit të të dhënave personale të cilat i ka në dispozicion, për shkak të ndalimit të qasjes së paautorizuar, zbulimit të paautorizuar ose eventualisht për shkak të keqpërdorimit të tyre. Procedurat e tona të sigurisë i nënshtrohen kontrolleve të rregullta dhe pasqyrojnë arritjet më të reja teknologjike në këtë fushë.

Ndryshime në këtë Politikë të privatësisë

Makedonski Telekom ka të drejtë që në çdo kohë ta ndryshojë apo ta plotësojë këtë Politikë për privatësi. Për çdo ndryshim apo plotësim do të publikohet një njoftim i dukshëm në këtë faqe të internetit.

Kontakt

Në qoftë se dëshironi të dhënat e Juaja të korrigjohen ose të fshihen ose në qoftë se keni çfarë do pyetje apo propozime për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të na kontaktoni në adresën elektronike:

data_protection@telekom.mk

Theksojmë se adresa elektronike prej të cilës do të na kontaktoni dhe të dhënat personale të tjera, si dhe përmbajtja e propozimeve dhe kërkesave të Juaja, nuk do të përdoren për asnjë qëllim tjetër, përveç se t'i përgjigjemi kërkesës, pyetjes apo propozimit tuaj që keni parashtruar për ne.

